



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 15, datë 30.04.2019

**“Mbi dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave  
bankës me emrin e ndryshuar “Banka OTP Albania SHA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 21, pika 2, të nenit 28, pika 3 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 8, pikat 3, 4, 5, 6, 8, 9 dhe 11 të Udhëzimit Nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka”, i ndryshuar, të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të shkresës së Bankës OTP Albania SHA nr. 400 prot., datë 16.04.2019, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

---

V E N D O S I:

1. Dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave bankës me emrin e ndryshuar nga “Banka Societe Generale Shqipëri” në “Banka OTP Albania SHA”.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave Bankës OTP Albania SHA.
3. Ngarkohet Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për prodhimin e certifikatës së re për Bankën OTP Albania SHA.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.
5. Të informohet Banka OTP Albania SHA dhe Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim, brenda 7 (shtatë) ditëve nga miratimi i tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar